



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit  
Opština Gjiçane  
Gjiçane Belediyesi

## DREJTORIA E ARSIMIT

---

Save the Children në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si dhe me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Gjiçane, është duke implementuar projektin ; Gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në institucionet fillore, në kuadër të këtij bashkëpunimi, DKA-ja shpall :

### K O N K U R S

**Vendi i punës :** Një mësimdhënës/e mbështetës/gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta

**Institucioni :** Shkolla fillore “ Thimi Mitko” në Gjiçane

Mësimdhënësi do të punojë me fëmijët të nivelit fillor 1-5 klasë.

Projekti zgjatë 3 (tri) vite

**Kualifikimet dhe shkathtësitë themelore:**

1. Niveli Master , arsimit gjithëpërfshirës apo arsimit me nevoja të veçanta
2. Fakulteti i Edukimit dhe Rehabilitimit- drejtimi përkatës
3. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë speciale
4. Fakulteti Filozofik dega e pedagogjisë
5. Fakulteti i Edukimit, programi i arsimit fillor

**Sqarim :** kandidatët të cilët aplikojnë dhe kanë përgaditje profesionale sipas pikës 4 dhe 5, në intervistë ftohen vetëm në mungesë të kandidatëve nga pika 1,2 dhe 3.

**Detyrat dhe roli i mësimdhënësit/es mbështetës/se**

- Vrojtton në klasa të rregullta në bashkëpunim me mësimdhënësit klasor/kujdestarët klasor nxënësit e nivelit të ulët (posaçërisht faza kalimtare nga klasa para fillore në klasën e parë dhe nga klasa e pestë në klasën e gjashtë) për të identifikuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore
- Mbështet nxënësit që kanë nevoja të veçanta arsimore dhe vështirësi në të nxënë në klasa të rregullta
- Planifikon dhe organizon bashkë mësimdhënie me mësimdhënësin e rregullt në klasa ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore
- Kur ka nevojë për punë individuale me ndonjë fëmijë dhe vlerësohet se kjo është e domosdoshme, atëherë punon me të individualisht jashtë klasës
- Përpilon planin individual të arsimit bashkë me mësimdhënësin e rregullt, prindin dhe anëtarët tjerët të ekipit të PIA dhe kur është e mundur edhe vetë nxënësin me nevoja të veçanta arsimore
- Përkujdeset që plani individual i arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të rishikohet dhe vlerësohet në periudha të rregullta kohore dhe kohë pas kohe të ripunohet nëse ka nevojë
- Këshillon dhe ndihmon mësimdhënësit e rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe si të menaxhoj me klasën gjithëpërfshirëse

- Harton materiale mësimore alternative bashkë me mësimdhënësit e klasës së rregullt të cilat do të përdoren në mësimdhënien me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore
- Ndhmon në vetëdijesimin e stafit të shkollës për procesin e gjithëpërfshirjes
- Ndhmon drejtorin e shkollës dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore
- Bashkëpunon me Qendrat burimore për integrimin e fëmijëve me NVA nga Qendra Burimore në shkollë të rregullt përgatit dhe mbështet procesin e integritit të fëmijës në klasë të rregullt.
- Bashkëpunon me mësimdhënësin e klasës së bashkangjitur në shkollën ku punon dhe planifikojnë së bashku mbështetjen për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore që janë në klasa të rregullta. Bashkë me mësimdhënësin e KB bëjnë integrimin e nxënësve nga klasa e bashkangjitur në klasë të rregullt të atyre fëmijëve që janë të gatshëm me integrim
- Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të mësimdhënies, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore varësisht nga nevojat specifike që paraqiten në shkollë.
- Planifikon në baza javore dhe mujore dhe i raporton drejtorit të shkollës ku punon për punën e bërë.

**Për vendin e punës në fjalë nevojiten këto dokumente:** diploma universitare , kopja e letërnjoftimit, certifikatat për trajnimet e kryera adekuate (trajnimet e vijuara mbi edukimin gjithëpërfshirës me theks të veçantë për fëmijë me nevoja të veçanta), vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile , me të cilin dëshkohet vendbanimi i kandidatit si dhe vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen, ndërsa dokumentet origjinale prezantohet në intervistë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre ( gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Kohëzgjatja e kontratës : deri në përfundim të projektit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Për vendin dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen menjëherë pas mbylljes së konkursit, përmes listës e cila do të vendoset në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit.

**Drejtori i drejtorisë**

**Nazmi Musa**